397
409 /22

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 178/23
Datë/Datum. 21.02.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2022:276595
Datë:	09.02.2023
Numri i dokumentit:	03963970

AA.nr.85/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditëses-propozueses Ministria e Shëndetësisë, kundër të paditurës-kundër propozueses Organi Shqyrtues i Prokurimit, me bazë juridike, anulim vendimi, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit -propozuesit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2953/2022, të datës 10.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 09.02.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses-propozueses Ministria e Shëndetësisë, e datës 25.01.2023, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2953/2022, i datës 10.01.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me aktvendimin e ankimuar, ka hedhë poshtë padinë dhe propozimin e paditëses Ministria e Shëndetësisë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, nën shenjën A.nr.2953/2022 e datës 21.10.2022, si e pa lejueshme.

Kundër këtij aktvendimi paditësja-propozuesja, ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës, shkeljes së ligjit material, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit si e bazuar, të ndryshohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2953/2022

2023:034055

ashtu që të aprovohet kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit 397, 409/22 i të padituës OSHP dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit shqyrtoi, shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, dhe 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Paditësja/propozuesja Ministria e Shëndetësisë, kundër të padituës Organi Shqyrtues i Prokurimit ka parashtruar padi për anulimin e vendimit nr.397,409/22 datë 11.10.2022 dhe të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me nr.05-3975 datë 12.08.2022, me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit nr.397,409/22 datë 11.10.2022.
Gjykata e shkallës së parë vlerëson se vendimi administrativ PSH.nr.397/22,409/22 datë 11.10.2022 i organi më të lartë administrativ, anulimi i të cilit kërkohet sipas padisë dhe shtyrja e ekzekutimit të të njëjtit, me të cilin e paditura anulon vendimin e datës *12.08.2022* dhe aktivitetet e prokurimit *kthehen në rivlerësim* dhe obligohet paditësi në cilësinë e autoritetit kontraktues që të *ri-vlerësoj ofertat* përkitazi me aktivitetin "Furnizim me Insulinë analoge nga Lista Esenciale" Lot 1 dhe 3, me numër të prokurimit 206-20-8397-1-1-1, në këtë kuptim vendimi i atakuar me të cilin anulohet akti administrativ i organit më të ulët administrativ dhe obligohet organi administrativ në rivlerësim të aktiviteti-rivlerësim të ofertave nuk përbën akt përfundimtar administrativ, pasi që me aktin administrativ PSH.nr.397/22, 409/22 datë 11.10.2022 kemi të bëjmë me kontroll administrativ nga vetë organi administrativ i shkallës më të lartë, për faktin se me të njëjtin anulohet vendimi i datës 12.08.2022 dhe çështja kthehet në rivlerësim lidhur me aktivitetin e prokurimit- rivlerësim të ofertave. Andaj me vendimin e të padituës ne pikën katër të tij obligohet paditësi që në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me aktivitetin e prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafin paraprak të dispozitivit të vendimit të atakuar. Gjykata në kuptim të neni 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative, konstaton se vendimi i atakuar me padi, me propozim të shtyrjes së ekzekutimit të të njëjtit nuk përbën vendim përfundimtar administrativ. Gjykata e kishte parasysh po ashtu faktin se sipas evidencës së kësaj Gjykate lidhur me vendimet e mëvonshme lidhur me këtë çështje *pas rivlerësimit të ofertave* është parashtruar nga këtu paditësi po ashtu padia e datës 23.12.2022.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 23.2 dhe 49 të LKA, lidhur me nenin 194 të LPK-së, (Ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA), dhe as me shkelje të tjera sipas pretendimeve në ankesë. Kolegji, njëjtë si gjykata e shkallës së parë, vlerëson se propozimi i paditësit sipas përmbajtjes së tij nuk është i bazuar në dispozitat ligjore të nenit 22 të LKA, i cili e rregullon mënyrën e parashtrimit të kërkesës për shtyrjen e vendimit përfundimtar të organit administrativ deri në vendosjen meritore të çështjes sipas padisë. Nga përmbajtja e propozimit nuk kërkohet pezullimi i asnjë akti administrativ përfundimtar, ashtu si parashihet me këtë dispozitë dhe nuk arsyetohet në këtë drejtim, mirëpo me padi ka kërkuar anulimin e vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë PSH.nr.397/22, 409/22 datë 11.10.2022, i cili nuk është akt përfundimtar administrativ.

2023:034055

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji i Gjykatës së Apelit, njëjtë si edhe gjykata e shkallës së parë, vlerëson se në këtë çështje nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të filluar procedura e shqyrtimit të çështjes në procedurë gjyqësore, të konfliktit administrativ, sipas dispozitave të nenit 13 të LKA-së i cili nen përcakton se: "*1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar*", për shkak se paditësi me padi nuk e konteston ligjshmërinë e asnjë vendimi administrativ përfundimtar, kundër të cilit ka mundur të hapet konflikti administrativ, për tu vlerësuar ligjshmëria e tij ashtu siç parashihet me nenin 9 të LKA-së, por me padi paditësi ka kërkuar anulimin e vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë, PSH.nr.397/22, 409/22 datë 11.10.2022 me propozim shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit, deri në marrjen e vendimit definitiv nga gjykata. Andaj duke u bazuar në nenin 15 par.1 nën par.1.2 të LKA-së "*Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet: 1.2 kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ*".

Theksimet në ankesë të cekura si më lartë dhe të tjerat, kolegji i shqyrtoi në baza ligjore, dhe i vlerëson se janë të pa bazuara, sepse paditësi në asnjë fazë të procedurës nuk ofron dëshmi që ka vepruar në baza ligjore sipas dispozitave të LKA-së, të cekura më lartë për fillimin e procedurës gjyqësore të konfliktit administrativ, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë, me që paditësi nuk e konteston ligjshmërinë e asnjë vendimi administrativ përfundimtar, e hedhë poshtë padinë dhe propozimin për masë si në vështrim të nenit 34 par.1 nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 9 të LKA-së, si të palejueshme.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA dhe neni 209, pika.b) i LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
AA.nr.85/2023, më datë 09.02.2023

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi

DAKTESINE E KOPJES E VERTETON
UDHEHEQESI I SHKRIMORES SE GJYKATES
TACNOST KOPIJE POTVRDUJE
RUKOVODIOC SUDSKE PISARNICE

2023:034055